

Raste të tjera të furnizimeve të përjashtuar nga TVSH-ja

Përjashtimi i gazetave, revistave dhe reklamës nga media e shkruar

Referuar nenit 53, të Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetatat, furnizimi i gazetave, i revistave, si dhe furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Konkretisht përjashtimi zbatohet për rastet si më poshtë:

a) **Shërbimin e shtypshkrimit të gazetave:**

Në këtë rast, personi i tatueshëm që kryen shërbimin e shtypshkrimit të gazetës, nuk i ngarkon TVSH, vlerës së tatueshme në faturën tatimore, të lëshuar për botuesin e gazetës.

Kujdes!

Furnizime të tjera të shtypshkrimit nuk përfitojnë nga përjashtimi.

b) **Shitja e gazetave, revistave dhe e Fletores Zyrtare të Republikës së Shqipërisë e botuar nga Qendra e Publikimeve Zyrtare:**

Kujdes!

Çdo material i ofruar jo në formën tradicionale të një gazete, reviste - pavarësisht përmbajtjes së tyre, - që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë ato elektronike, nuk është i përjashtuar në kuptim të këtij neni.

c) **Furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar:**

Vlera e tatueshme në faturat tatimore, që mediat e shkruara lëshojnë për porositësit e reklamave, nuk ngarkohet me TVSH.

Përjashtime të tjera

Raste të veçanta të përjashtimit nga TVSH-ja:

a) furnizimi i kartave të identitetit për shtetasit;

Kujdes!

Furnizimi i pasaportave për shtetasit nuk është furnizim i përjashtuar nga TVSH.

- b) Furnizimet e mallrave të luajtshme, të përdorura për një veprimtari të përjashtuar, vetëm në rastin kur këto mallra nuk kanë qenë objekt i së drejtës së zbritjes së TVSH-së;
- c) Furnizimet e mallrave, për të cilat TVSH-ja nuk ishte e zbritshme, në blerjen ose përdorimin e tyre.

Ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimet e përjashtuara

Qiradhënia e ndërtesave mbi 2 muaj:

Pavarësisht se qiradhënia e ndërtesave për periudha mbi 2 muaj, trajtohet si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, personi i tatueshëm që kryen veprimtari të qiradhënies së ndërtesës, gëzon të drejtën e zgjedhjes, për ta trajtuar qiradhënien e ndërtesave si furnizim të tatueshëm me TVSH 20%.

Kujdes!

Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet për qiradhënien e ndërtesave për banim.

Furnizimi i ndërtesave:

Pavarësisht se furnizimi (shitja) i ndërtesës apo pjesëve të saj, trajtohet si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, personi i tatueshëm që furnizon ndërtesën ose pjesë të një ndërtese, gëzon të drejtën e zgjedhjes, për ta trajtuar këtë furnizim si furnizim të tatueshëm me TVSH 20%.

Kujdes!

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së, për furnizimin e ndërtesës ose të pjesëve të një ndërtese, është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm, që furnizojnë apartamente, ndërtesa apo ambiente për banim ose kur blerësi është një individ.